

VENDIM
Nr. 877, datë 18.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NËPUNËSVE TË DISA
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. I/4, “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë për nëpunësit dhe punonjësit mbështetës në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme”, e vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, e ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen nr. I/4, “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë për nëpunësit dhe punonjësit mbështetës në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Prokurorisë së Posaçme”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019, të përballohen nga buxheti i miratuar për Prokurorinë e Posaçme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. I/4

**RENDITJA E POZICIONEVE TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR NËPUNËSIT DHE
PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
DHE NË PROKURORINË E POSAÇME**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit Oficer informacioni në Prokurorinë e Posaçme Sekretare Punonjës i postës sekrete	VIII	
2	Shofer i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Teknik mirëmbajtjeje Operator Magaznier	VII	
3	Shofer i postës sekrete Kuzhinier në Prokurorinë e Posaçme	VI	
4	Shoferë të tjerë të institucionit	V	
5	Punonjës pastrimi	III	

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.